



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.1102/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtarit të Lartë Ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesat e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, që ka të bëjë me votat e shpallura si të pavlefshme dhe të pa plotësuara (të zbrazëta), për Rundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të mbajtura me datë 19.11.2017, për Kryetar të Komunës në Prishtinë, në seancën e panelit të mbajtur, me datë 22.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHEN si të bazuar ankesat e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, ZL.Anr. 1102/2017, ZL.Anr. 1109/2017 dhe ZL.Anr. 1110/2017 te datës 20.11.2017, me të cilat ka kërkuar që të rinumërohen-rivlerësohen fletëvotimet e pavlefshme, fletëvotimet e përdorura nga votuesit por te pa plotësuara (të zbrazëta), të cilat kanë qenë në kutin e votimit dhe te rinumërohen te gjitha fletëvotimet e rregullta në këto Vendvotime:

1901E/01R	1904E/03R	1906E/09R	1909E/05R	1913E/03R
1901E/02R	1904E/04R	1906E/10R	1909E/06R	1913E/04R
1901E/03R	1904E/05R	1906E/11R	1909E/07R	1913E/05R
1901E/04R	1904E/06R	1906E/12R	1909E/08D	1913E/06R
1901E/05D	1904E/07R	1906E/13R	1910E/01R	1913E/07R
1902E/01R	1904E/08R	1906E/14R	1910E/02R	1913E/08R
1902E/02R	1904E/09R	1906E/15R	1910E/03R	1913E/09D
1902E/03R	1904E/10R	1906E/16R	1910E/04R	1914E/01R
1902E/04R	1904E/11R	1906E/17R	1910E/05R	1914E/02R
1902E/05R	1904E/12R	1906E/18R	1910E/06D	1914E/03R
1902E/06R	1904E/13D	1906E/19R	1911E/01R	1914E/04D
1902E/07R	1905E/01R	1906E/20R	1911E/02R	1915E/01R
1902E/08D	1905E/02R	1906E/21R	1911E/03R	1915E/02R
1903E/01R	1905E/03R	1906E/22R	1911E/04R	1915E/03R
1903E/02R	1905E/04R	1906E/23D	1911E/05R	1915E/04R
1903E/03R	1905E/05D	1907E/01R	1911E/06R	1915E/05R
1903E/04R	1906E/01R	1907E/02R	1911E/07D	1915E/06R
1903E/05R	1906E/02R	1907E/03R	1912E/01R	1915E/07D
1903E/06R	1906E/03R	1907E/04D	1912E/02R	1916E/01R
1903E/07R	1906E/04R	1908E/01D	1912E/03R	1916E/02R
1903E/08R	1906E/05R	1909E/01R	1912E/04R	1916E/03R
1903E/09D	1906E/06R	1909E/02R	1912E/05D	1916E/04D
1904E/01R	1906E/07R	1909E/03R	1913E/01R	1917E/01R
1904E/02R	1906E/08R	1909E/04R	1913E/02R	1917E/02R

1917E/03R	1920X/04R	1925E/03R	1937E/01D	BM219/001
1917E/04R	1920X/05R	1925E/04R	1939E/01D	BM219/002
1917E/05R	1920X/06D	1925E/05D	1940E/01R	CB119/001
1917E/06R	1921E/01R	1926E/01R	1940E/02R	CB119/002
1917E/07D	1921E/02R	1926E/02R	1940E/03D	CB119/003
1918E/01R	1921E/03R	1926E/03R	1941E/01D	CB119/004
1918E/02R	1921E/04R	1926E/04D	1942E/01D	CB119/005
1918E/03R	1921E/05D	1927E/01R	1943E/01D	CB119/006
1918E/04R	1921X/01R	1927E/02R	1949E/01R	CB119/007
1918E/05D	1921X/02R	1927E/03R	1949E/02D	CB119/008
1919E/01R	1921X/03R	1927E/04R	1951E/01D	CB119/009
1919E/02R	1921X/04R	1927E/05R	1952E/01D	CB119/010
1919E/03R	1921X/05R	1927E/06R	1953E/01D	CB219/001
1919E/04R	1921X/06D	1927E/07R	1954E/01D	CB219/002
1919E/05R	1922E/01R	1927E/08D	1955E/01D	CB219/003
1919E/06R	1922E/02R	1928E/01R	1956E/01R	CB219/004
1919E/07D	1922E/03R	1928E/02D	1956E/02D	CB219/005
1919X/01R	1922E/04R	1929E/01D	1957E/01D	CB219/006
1919X/02R	1922E/05R	1930E/01D	1958E/01D	CB219/007
1919X/03R	1922E/06R	1931E/01R	1959E/01D	CB219/008
1919X/04D	1922E/07R	1931E/02R	1960E/01R	CB219/009
1920E/01R	1922E/08R	1931E/03D	1960E/02R	CB219/010
1920E/02R	1922E/09D	1933E/01R	1960E/03D	
1920E/03R	1923E/01R	1933E/02D	1961E/01D	
1920E/04R	1923E/02D	1934E/01R	1962E/01D	
1920E/05R	1924E/01R	1934E/02R	1963E/01D	
1920E/06D	1924E/02R	1934E/03D	BM019/001	
1920X/01R	1924E/03D	1935E/01R	BM019/002	
1920X/02R	1925E/01R	1935E/02D	BM119/001	
1920X/03R	1925E/02R	1936E/01D	BM119/002	

II. URDHËROHET Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, ti rinumëron-rivlerëson fletëvotimet e **pavlefshme**, fletëvotimet e përdorura nga votuesit **por te pa plotësuar** (të zbrazëta), të cilat kanë qenë në kutin e votimit dhe te rinumërohen te gjitha **fletëvotimet e rregullta** si ne pjesën e I (parë), te dispozitivit të këtij vendimi,

III. VLERËSIMI i Votave të pavlefshme dhe rishikimi i votave të hedhura si të pa plotësuar, të bëhet konform, Doracakut te Procedurave te Votimit dhe Numërimit te KQZ-së, për vlerësimin e fletëvotimeve të vlefshme dhe të pavlefshme, në prezencën e vëzhguesve të subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, vëzhguesve nga Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosja dhe vëzhguesve të interesuar nga organizatat e akredituar për vëzhgim të procesit zgjedhor nga KQZ-ja, për këto zgjedhje dhe mediave.

IV. REZULTATI që del nga rivlerësimi dhe rinumërimi si në pjesën e II të dispozitivit të këtij vendimi, duhet të përfshihet me rastin e shpalljes se rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja.

A r s y e t i m

Më datën 20.11.2017, PZAP-i, ka pranuar ankesat me numër ZL. Anr 1102/2017, ZL. Anr 1109/2017, ZL. Anr 1110/2017 të datës 20.11.2017 të parashtuara nga subjekti politik Lidhja

Demokratike e Kosovës (LDK), me të cilën kërkon që të rinumërohen të gjitha kutitë e votimit në të gjitha Qendrat e Votimit në Komunën e Prishtinës, për shkak të rezultatit të ngushtë të dy kandidatëve dhe mospërpërputhjeve të shumta të cilat shihen të shpallja e rezultateve preliminare nga ana e KQZ-së. Sipas parashtruesit të ankesës rinumërimi i votave duhet të bëhet edhe për shkak të presionit të mbështetësve të Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) pranë qendrave të votimit si dhe sms-të e dërguara për ta votuar Shpend Ahmetin. Ne vazhdim parashtron se vëzhguesit e LDK-se nga shumica dërmuese e vendvotimeve kanë raportuar (ne disa raste dhe duke i shënuar në Librin e votimit) se komisionarët e VV-se sidomos në vendvotimet ku ishin në rolin e kryesuesve të KVV-se, duke e ditur rezultatin e ngushtë të kandidatëve, kanë shpallur me qindra fletëvotime të pavlefshme dhe me qindra tjera i kanë konsideruar si të zbrazëta pavarësisht se në ato fletëvotime qartazi mund të vërehej (vullneti i shprehur i votuesit).

Prandaj, duke pasur parasysh deklaratimet e ofruara nga shume vëzhgues për parregullsitë në vendvotime, numrin e madhe të fletëvotimeve të pavlefshme dhe të zbrazëta, me qëllim të mos Pranimit konstatimit të rezultatit përfundimtarë, kanë kërkuar nga PZAP-i që të bëjë verifikimin e të gjitha këtyre fletëvotimeve për të eliminuar çdo dyshim dhe për të ruajtur besimin në procesin zgjedhor.

Parashtruesi i ankesave në mbështetje të pretendimeve në ankesa si dëshmi ka bashkangjitur deklaratatë të katër votuesve, kopjet e Formularëve të zgjedhjeve, kopjet e Fletëvotimeve të plotësuar dhe të pavlefshme, sms si dhe fotografi nga dita e votimit.

Paneli i PZAP-it, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurat e PZAP-it, ka bashkuar ankesat dhe i ka trajtuar si një ankesë të evidentuar me ZL Anr. 1102/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve ankimore, dhe për të gjitha ankesat vendosi me një vendim, për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të ankesave dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, si dhe vlerësimit të provave të bashkangjitura në ankesa në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesat janë të bazuara

Paneli gjatë vlerësimit të pretendimeve ankimore në ankesa si dhe provave të bashkangjitura gjeti se pretendimet ankimore të ankuesve janë të bazuara, duke pas parasysh numrin e madhe të fletëvotimeve të pavlefshme dhe të zbrazëta dhe veçanërisht rezultatin e ngushtë në mes të dy kandidatëve dhe mospërpërputhjeve të shumta të votave të pavlefshme dhe të zbrazëta. PZAP-i, vlerëson se këto të dhëna me parregullsitë e theksuara më lart, do të kenë ndikim në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve, andaj me qëllim të eliminimit të çdo dyshimi dhe për të ruajtur besimin dhe transparencën në procesin zgjedhor PZAP-i, urdhëron KQZ-në, që në të gjitha vendvotimet e cekura në pjesën e I të dispozitivit të këtij vendimi, të rivlerëson dhe rinumëron fletëvotimet e **pavlefshme**, fletëvotimet e përdorura nga votuesit **por të pa plotësuar** (të zbrazëta), të cilat kanë qenë në kutin e votimit dhe të rinumërohen të gjitha **fletëvotimet e rregullta** në të gjitha Qendrat e Votimit në Komunën e Prishtinës.

Vendimi i PZAP-it ka mbështetje të nenit 106. 2 të LZP-së, ku përcaktohet:” Para certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve, KQZ-ja mund të urdhërojë rinumërimin e votave në cilindo vendvotim, qendër të numërimit ose edhe përsëritjen e votimit në një qendër votimi apo në një komunë”

PZAP-i, më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura vendimin e ka bazuar në nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze .*

Vlerësimi i votave të pavlefshme dhe rishikimi i votave të hedhura si të pa plotësuara, duhet të bëhet konform, Doracakut te Procedurave te votimit dhe numërimit te KQZ-se, për vlerësimin e fletëvotimeve të vlefshme dhe të pavlefshme, dhe me qëllim të transparencës rinumërimi dhe rishikimi i votave duhet të bahet në prezencën e vëzhguesve të subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, vëzhguesve nga Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosja dhe vëzhguesve te interesuar nga organizatat e akredituar për vëzhgim të procesit zgjedhor nga KQZ-ja, për këto zgjedhje dhe mediave.

Rezultati që del nga vlerësimet e bëra si në pjesën e II të dispozitivit, të këtij vendimi, duhet të përfshihet në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve.

Andaj, Paneli në kuptim të nenit 117, 118 dhe nenit 120 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.1102/2017 me datën 22.11.2017

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi Gjykatës Supreme të Kosovës.

